



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr. 1428/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Redoni H M” Sh.P.K, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Armend Tarani, nga Prishtina, kundër të paditurve Organi Shqyrtues i Prokurimit, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Erëlehta Popaj, dhe Ministria e Shëndetësisë, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr.126/18 të datës 11.05.2018 dhe kompensimit të dëmit, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 05.09.2023 në prezencë të përfaqësuesve të autorizuar të palëve, me datë 13.09.2023 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Redoni H M” Sh.P.K., ashtu që ANULOHET Vendimi Psh.nr. 126/18 i datës 11.05.2018 i nxjerrë nga i padituri i parë Organi Shqyrtues i Prokurimit, dhe Njoftimi për Anulimin e Dhënies së Kontratës i datës 16.03.2018 për aktivitetin e prokurimit numër 206-17-3219-1-1-1, i nxjerrë nga i padituri i dytë Ministria e Shëndetësisë.
- II. OBLIGOHET i padituri i dytë Ministria e Shëndetësisë që paditësit “Redoni H M” Sh.P.K., në emër të kompensimit të dëmit për shkak të fitimit të humbur, ti paguaj shumën prej 274,711.50€ (dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë euro e pesëdhjetë cent) me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit e deri në përmbushjen përfundimtare, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.
- III. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit “Redoni H M” Sh.P.K. kundër të paditurit të dytë Ministria e Shëndetësisë me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit për shkak të fitimit të humbur përtej shumë së gjykuar në pikën II të këtij dispozitivi e

deri në shumën 117,733.50€ (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre euro e pesëdhjetë cent).

IV. Ky Aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues.

V. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

Paditësi “Redoni H M” Sh.P.K. ka parashtruar padi kundër të paditurve Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) dhe Ministrisë së Shëndetësisë me kërkesë për anulimin e vendimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit nr. 126/18 të datës 11.05.2018 si i kundërligjshëm, me arsyetimin se anulimi i njoftimit për dhënie të kontratës nga Ministria e Shëndetësisë dhe i vërtetuar nga OSHP është i kundërligjshëm pasi që asnjë dispozitë ligjore nuk lejon që pas vlerësimit të ofertave dhe shpalljes së njoftimit për dhënie të kontratës të anulohet njoftimin për dhënie të kontratës dhe ka theksuar se Ministria nuk ka të drejtë ligjore të refuzojë nënshkrimin e kontratës publike. Paditësi tutje shton se i padituri i parë në shqyrtimin e ankesës nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike pasi që raportet e Agjencisë së Kosovës për Produkte Medicinale dhe Inspektoratit Farmaceutik për hulumtim të çmimeve të tregut nuk mund të merret parasysh për arsye se këto institucione nuk janë të autorizuar për hulumtim të tregut. Paditësi shton se me të drejtë është zgjedhur “Redoni H M” Sh.P.K., si fituese e tenderit për aktivitetin e prokurimit me nr. 206-17-3219-111 dhe me titull “Furnizim me Citostatik” për Lot 17, për arsye se ofertën për tender e kanë bërë sipas çmimeve të tregut dhe kanë ofertuar çmimin më të lirë i cili ka qenë në pajtim me vlerën e parashikuar të kontratës. Në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësi ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësit ta aprovon në tërësi si të bazuar. Lidhur me pretendimet e të paditurit të dytë për legjitimitetin real pasiv ka theksuar se Ministria e Shëndetësisë ka legjitimitet për të qenë i paditur për shkak të dëmeve të shkaktuara paditësit duke bërë anulimin e njoftimit për dhënies e kontratës si veprim i kundërligjshëm. Përfaqësuesi i paditësit në seancë gjyqësore të datës 05.09.2023 ka bërë precizimin e petitumit të kërkesëpadisë ku ka kërkuar dëmshpërblim nga i padituri në vlerë prej 392,445.00€ për dëmin financiar të pësuar, me kamatë vjetore prej 8% nga dita e paraqitjes së

padisë në Gjykatë e deri në pagesën definitive si dhe anulimin e vendimit kontestues nr. 126/18 i datës 11.05.2022.

I padituri i parë me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se OSHP ka bërë anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës bazuar nga raportet e Agjencisë së Kosovës për Produkte Medicinale dhe Inspektoratit Farmaceutik ku konstatohet se çmimi i rekomanduar i “Redoni H M” Sh.P.K., ka qenë më i lartë se çmimi në treg. Tutje shton se kontrata nuk ka qenë e nënshkruar nga Ministri i Shëndetësisë prandaj e njëjta nuk është e zbatueshme. Ka shtuar se OSHP ka kompetenca ta shfuqizojë plotësisht apo pjesërisht kontratat publike në rastet e caktuara kur nënshkrimet e këtyre kontratave apo zbatimet e tyre janë të dëmshme dhe me pasoja për interesin publik prandaj nënshkrimi i kësaj kontrate do të kishte pasoja në fondet publike. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka qëndruar në tërësi pranë deklarimeve në përgjigje në padi dhe ka shtuar se me të drejtë është anuluar vendimi për arsye se blerja e këtij produkti me çmim të rekomanduar nga paditësi do të shkaktonte dëm të madh dhe të panevojshëm buxhetit të Republikës së Kosovës. Gjykatës i ka propozuar që padia e paditësit të refuzohet si e bazuar dhe ta lejë në fuqi vendimin për anulim të dhënies së kontratës.

I padituri i dytë me përgjigje në padi konsideron se në këtë çështje i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë në procedurë pasi që i padituri kërkon anulimin e vendimit të një organi të pavarur dhe kërkon nga Gjykata që ta detyrojë paditësin që të bëjë precizimin e padisë në aspektin subjektiv apo ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pabazuar. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka qëndruar në tërësi pranë deklarimeve në përgjigje në padi dhe ka shtuar se e paditura e dytë nuk ka asnjë obligim ndaj paditësit pasi që paditësi nuk ka lidhur marrëveshje kontraktuale me të paditurin e dytë dhe në këtë rast nuk janë krijuar të drejta dhe detyrime mes tyre. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësit sa i përket të paditurës së dytë për shkak të legjitimitetit real pasiv.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Konkluzioni nr.31/18 i datës 04.05.2018; Vendimi PSH.nr.126/18 i datës 11.05.2018; Ankesë nr.126/18 i datës 05.04.2018; Kërkesë për rishqyrtim i datës 23.03.2018; Raport i ekspertit shqyrtues; Komunikim me email i datës 16.10.2017; Kontratë kornize publike nr.REF 206-17-

030-111 për O.E “Redoni H M”; Komunikim me email i datës 30.04.2018 për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së ofertës; Komunikim me email i datës 17.11.2017 dhe 30.04.2018; Komunikim me email i datës 04.06.2018; Raport i vlerësimit të tenderëve i datës 02.10.2017; Njoftim për kontratë i datës 14.07.2017; Procesverbal i hapjes së tenderit i datës 24.08.2017; Njoftim për dhënie të kontratës i datës 03.10.2017; Të dhënat nga ARBK për “Exclusive” Shpk, “Exclusive Corporation” Shpk; Komunikim me email i datës 22.12.2017 së bashku me tre dokumente me titull “Prezantohet raporti dhe dokumentari “Depoja e keqpërdorimeve farmaceutike”; Komunikim me email nga KRPP me titull “Kërkesë për interpretim ligjor” i datës 19.01.2018; Komunikim me email i datës 26.12.2017 me titull “ Raport mbi importin mbi produktin farmaceutik – Imatinib; Kërkesë për opinion ligjor i datës 05.01.2018; Urdhëresë PSH.nr.273/17 dhe PSH.nr 324/17 të lëshuara nga OSHP; Njoftim për dhënie të kontratës i datës 18.05.2016; Certifikata e regjistrimit të biznesit dhe informatat për “Redoni H M” Sh.p.k.; Vendim nr.21/19 i datës 23.05.2019 i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, Formular për dorëzimin e tenderit me shkresat përcjellëse, Njoftimi për anulimin e dhënies së kontratës e datës 16.03.2018 i nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë; ekspertiza financiare e ekspertit R.B. e datës 15.09.2023 dhe plotësimi i ekspertizës financiare e hartuar nga eksperti R.B. me datë 03.07.2023.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, thëniet në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurit si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pjesërisht e bazuar.

Me vendimin PSH.nr.126/18 i datës 11.05.2018 Paneli Shqyrtues i OSHP i ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik “Redoni H M” Sh.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit nr. 206-17-3219-111, me titull “Furnizim me Citostatik” për Lot 17, dhe ka vërtetuar njoftimin për anulimin e dhënies së kontratës të datës 16.03.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit të theksuar më lartë, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë me arsyetimin se pas shqyrtimit të ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore të paditësit, ekspertizës nga eksperti shqyrtues i cili propozon panelit shqyrtues që ankesa e paditësit të aprovohet si e bazuar, pas dëgjimit të deklaratave të përfaqësuesve të OE “Redoni H M” Sh.P.K., dhe Autoritetit Kontraktues në seancë të shqyrtimit kryesor të datës 27.04.2018, ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka bërë anulimin e dhënies së kontratës duke u bazuar në nenin 62 par. 1.1

të LPP-së me arsyetimin se rekomandimi dhe interpretimi ligjor i lëshuar nga KRPP kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës dhe një urdhër i lëshuar nga OSHP kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës, gjithashtu thekson pas konstatimeve të Agjencisë së Kosovës për Produkte Medicinale dhe Inspektoratit Farmaceutik të Kosovës lidhur me çmimin e produktit në treg del se kemi të bëjmë me shkelje të nenin 4 par.2 pika C të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik i cili përcakton se: *“çmimi i kontraktuar nuk duhet të jetë më i lartë se çmimi i tregut.”*

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka ushtruar padi në gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 99 par. 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenin 56 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, i cili përcakton se: *“3. Të gjitha vendimet e nxjerra nga OSHP mund të shqyrtohen nga Gjykata kompetente në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative”* si dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative”*.

Gjykata i vlerësoi të bazuara pretendimet e paditësit për anulimin e vendimeve kontestuese pasi që i padituri nuk i ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat ligjore, duke mos i shqyrtuar drejtë provat për vërtetimin e gjendjes së saktë faktike, lidhur me përfundimin e aktivitetit të prokurimit në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik.

Gjykata, nga provat e administruara në këtë çështje të konfliktit administrativ ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Nga Njoftimi për kontratë i datës 14.07.2017, gjykata ka konstatuar se autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit nr. 206-17-3219-1-1-1 dhe nr. të brendshëm 206-17-030-111 me titull “Furnizimi me Citostatik nga Lista

Esenciale” i cili ka qenë i ndarë në 25 lote dhe për Lot 17 është kërkuar produkti Imatinib Mesylate tbl 400mg.

Nga Formulari për dorëzimin e tenderit me shkresat përcjellëse, gjykata ka konstatuar se paditësi ka aplikuar në aktivitetin e prokurimit “Furnizim me citostatik nga lista esenciale” me nr. të prokurimit 206-17-030-111 për Lot 17 produktin Imatinib mesylate 400mg, me çmim total të tenderit prej 648,000.00€ për sasinë prej 27,000.00 tableta, përkatësisht me çmim prej 24€ për tabletë.

Nga Procesverbali i hapjes së tenderit i datës 24.08.2017, gjykata ka konstatuar se Komisioni për hapjen e ofertave ka konstatuar në aktivitetin “Furnizim me citostatik nga lista esenciale” Lot 17 kanë ofertuar 2 operator ekonomik: “Exclusive Corporation” Sh.P.K., me çmim 918,000.00€ dhe “Redoni H M” Sh.P.K., me çmim 648,000.00€.

Nga Raporti i vlerësimit të tenderëve i datës 02.10.2017, gjykata ka konstatuar e paditura Ministria e Shëndetësisë me datë 02.10.2017 ka përgatitur raportin e vlerësimit të tenderit “Furnizim me citostatik nga lista esenciale” me nr. të prokurimit 206-17-030-111, përmes të cilit komisioni i vlerësimit rekomandon paditësin si tenderues i suksesshëm me çmimin më të lirë për dhënie të kontratës për Lot 17 dhe përmes dokumentit lidhur me kërkesat e pranueshmërisë të nënshkruar nga zyrtari i prokurimit A.P. me datë 03.10.2017 paditësi është shpallur fitues i tenderit.

Nga Njoftimi për dhënie të kontratës i datës 03.10.2017, gjykata ka konstatuar se i padituri i dytë ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës për “Furnizim me citostatik nga lista esenciale” me nr. të prokurimit 206-17-030-111 për Lot 17, për operatorin ekonomik “Redoni H M” Sh.P.K., me çmim 648,000.00€ për 24 muaj si ofertuesi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Nga Komunikim me email i datës 16.10.2017, gjykata ka konstatuar se fillimisht përfaqësuesi i të paditurit të dytë i ka dërguar paditësit draft kontratën dhe po të njëjtën ditë paditësi ka dorëzuar draft kontratën tek z. B.B. – përfaqësues i të paditurit me plotësimet e kërkuara.

Nga Kontrata kornizë publike nr. REF 206-17-030-111 për OE “Redoni H M”, gjykata ka konstatuar se i padituri i dytë ka përgatitur kontratën kornizë publike për 24 muaj për aktivitetin e prokurimit të lartcekur për palët Ministria e Shëndetësisë si autoritet kontraktues dhe “Redoni H M” si i rekomanduar për kontratë për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me Citostatik nga L.E.”

Nga Komunikimi me email i datës 17.11.2017 dhe 30.04.2018, gjykata ka konstatuar se paditësi përmes email të datës 17.11.2017 ka njoftuar z. B.B. dhe z. B.M. se janë duke pritur për të nënshkruar kontratën sipas njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit nr. 206-17-030-111 Lot 17 duke theksuar se sipas ofertës vlefshmëria skadon 90 ditë pas hapjes dhe vonesa që janë dukë bërë është e kundërligjshme. Ndërlidhur me këtë nga komunikim me email i datës 30.04.2018, gjykata ka konstatuar se Zyrtari për punë dhe shërbime të konsulencës nga Divizioni i Prokurimit të Ministrisë së Shëndetësisë z. B.M. ka kërkuar nga paditësi vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së ofertës edhe për 60 ditë, ndërsa paditësi ka njoftuar se vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës e kanë bërë me datë 17.11.2017 ku edhe i kanë njoftuar me email se oferta nga emaili i paditësit me 17.11.2017 vlen edhe 24 muaj pas skadimit të ofertës.

Nga Komunikimi me email i datës 22.12.2017 se bashku me tre dokumente me tituj “Prezentohet raporti dhe dokumentari Depoja e keqpërdorimeve farmaceutike”, gjykata ka konstatuar se përmes këtij komunikimi me email është bashkangjitur raporti për rastin Imatinib me titull “raporti rreth produktit Imatinib tlb 400mg i përfunduar” i cili është dërguar tek z. N.B., z. A.F. dhe z. J.SH.. Në raportin me titull “raport rreth produktit Imatinib tlb 400mg” theksohet se pas hulumtimeve të tregut nga IFPPM për verifikimin e çmimit të importit dhe të shitjes me shumicë dhe pakicë lidhur me produktin Imatinib 400mg është gjetur se në tregun e Kosovës ekziston vetëm një produkt Imatinib 400mg, 30 tableta, nga prodhuesi Remedica L.T.D me importues Exclusive Gjilan dhe ka konstatuar se nga hulumtimi në treg çmimi i produktit varion nga 4.83 euro për një tabletë deri në 32 euro për një tabletë.

Nga Komunikimi me email i datës 26.12.2017 me titull “raport mbi importin mbi produktin farmaceutik – Imatinib”, gjykata ka konstatuar se përmes komunikimit me email z. A.F. ka kërkuar opinion ligjor nga KRPP për detyrimin ligjor të zyrtarëve përgjegjës për nënshkrimin e kontratës në përputhje me nenin 26 të Ligjit të Prokurimit në lidhje me aktivitetin e prokurimit të cekur më lartë.

Nga Kërkesa për opinion ligjor i datës 05.01.2018, gjykata ka konstatuar se z. A.F., udhëheqës i divizionit të prokurimit në Ministrinë e Shëndetësisë i kishte parashtruar KRPP-së kërkesë për opinion ligjor për aktivitetin kontraktues Furnizim me citostatik nga lista esenciale” me nr. të prokurimit 206-17-030-111, Lot 17.

Nga Komunikimi me email nga KRPP me titull “Kërkesë për interpretim ligjor” i datës 19.01.2018, gjykata ka konstatuar se përmes komunikimit me email KRPP i është përgjigjur kërkesës për interpretim ligjor lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me citostatik nga lista esenciale” me nr. të prokurimit 206-17-030-111 Lot 17 dhe ka dhënë sqarimet për Autoritetin Kontraktues se neni 1 par.1 i LPP-së përcakton se qëllimi i LPP-së është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike dhe gjatë parashikimit të vlerës së kontratës sipas nenit 13 par.2 të RrUOPP, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasysh çmimet e publikuara nga zyra e Statistikave të Kosovës dhe çmimet tjera indikativë, çmimet e tregut lokal, çmimet e kontratave paraprake të nënshkruara nga AK, çmimet ndërkombëtare dhe se neni 4.2 i RrUOPP obligon AK që të sigurohet që çmimi i kontraktuar të mos jetë më i lartë se çmimi i tregut dhe ka rekomanduar AK që të analizojë me kujdes dhe në mënyrë profesionale të dhënat nga shkresat e lëndës lidhur me dëmet që mund ti sjellë autoriteti kontraktues lidhja e një kontratë të tillë si dhe të sigurohet të marr masa ndaj zyrtarëve përgjegjës. Në fund ka dhënë vërejtje për autoritetin kontraktues se “duke pas parasysh se faza në të cilën autoriteti kontraktues ndodhet (kur të gjitha afatet për kontestimin e kontratës kanë kaluar) dhe kushtet mbi të cilat një aktivitet i prokurimit mund të konsiderohet i përfunduar (nenit 62 i LPP-së dhe / ose neni 44 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik) autoriteti kontraktues duhet të ketë parasysh pasojat eventuale nga cili do vendim që merr. Gjithsesi mbetet në përgjegjësinë e Autoriteti Kontraktues në këtë rast MSH-së në rast të konsekuencave që mund të rrjedhin nga vendimet për anulim apo vendimin për nënshkrim të kontratave dhe fillimin e zbatimit të tyre.”

Nga Njoftimi për anulimin e dhënies së kontratës i datës 16.03.2018 e nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë, gjykata ka konstatuar se Ministria e Shëndetësisë ka lëshuar njoftimin për anulimin e dhënies së kontratës ndaj operatorit ekonomik “Redoni H M” Sh.P.K., me datë 16.03.2018 me arsyetimin se një urdhër i lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës dhe një rekomandim i lëshuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës dhe se në fazën e nënshkrimit janë kërkuar informata shtesë mbi çmimet e tregut nga menaxhmenti i lartë i Ministrisë së Shëndetësisë dhe në bazë të dhënave të ofruara nga komisioni për verifikim të çmimeve si dhe kontrollimi i procedurës së prokurimit është konstatuar se ky aktivitet ka devijime nga LPP.



Nga Kërkesa për rishqyrtim i datës 23.03.2018, gjykata ka konstatuar se paditësi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim lidhur me tenderin për furnizim me citostatik nga lista esenciale, Lot 17, për aktivitetin e prokurimit 206-17-3219-1-1-1, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë duke kërkuar anulimin e vendimit për anulim të dhënies së kontratës si i kundërligjshëm bazuar në nenin 7, neni 26 dhe neni 62 të LPP-së.

Nga Raporti i ekspertit shqyrtues, gjykata ka konstatuar se eksperti i prokurimit ka hartuar ekspertizën në lidhje me ankesën e OE “Redoni H M” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me citostatik nga lista esenciale, Lot 17”. Eksperti shqyrtues ka konstatuar se janë të bazuara pretendimet ankimore të paditësit duke vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka bërë anulimin e aktivitetit kontraktues të cekur më lartë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së për arsye se nuk mund të anulohet aktiviteti i prokurimit pas fazës së njoftimit për dhënien e kontratës dhe i ka propozuar panelit shqyrtues se ankesa e paditësit të aprovet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe ka rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim. Nga Komunikimi me email i datës 04.06.2018, gjykata ka konstatuar se z. B.B. përmes komunikimit me email ka kërkuar nga paditësi dorëzimin e vërtetimit të lëshuar nga gjykata kompetente dhe vërtetimit të lëshuar nga ATK si dokumente vetëm për fituesin para dhënies së kontratës për tenderin “Furnizim me citostatik nga lista esenciale” me nr. të prokurimit 206-17-030-111 Lot 17.

Nga Urdhëresa PSH.nr.273/17 dhe PSH.nr.324/17 të lëshuara nga OSHP, gjykata ka konstatuar se Organi Shqyrtues i Prokurimit në raste të ngjashme ka lëshuar urdhëresën ndaj Autoritetit Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë që të zbatoj njoftimin për dhënie të kontratës për aktivitetet e tjera të prokurimit me arsyetimin se pasi që janë kaluar të gjitha fazat tjera procedurale në lidhje me këto aktivitete të prokurimit dhe është bërë publikimi i njoftimit për dhënie të kontratës atëherë konsiderohet se të gjitha procedurat kanë qenë në rregull.

Nga Konkluzioni nr.31/18 i datës 04.05.2018, gjykata ka konstatuar se Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ka filluar procedurën hetimore ndaj OE “Redoni H M”, “Exclusive Corporation” Sh.P.K., dhe “Exclusive” Sh.P.K., për shkak të dyshimeve për marrëveshje të ndaluar ose praktikave të bashkërenduara sipas nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës për arsye se nga inspektimi i bërë në barnatore të qytetit të Prishtinës për të vërtetuar çmimin e tregut për barin IMAKREBIN – Imatinib Meszlate 400mg del se çmimi doganor importues dallon me

çmimin ofertues të kompanive prej 400%. Gjykata po ashtu ka konstatuar se hetimi ndër të tjera do të zhvillohet për Draft Kontratën (e pa nënshkruar – në procedurë ankimimi në OSHP) me ref. 206/017/030/111 – Lloti 17 si dhe çdo dokumentacion tjetër që lidhet me barin IMAKREBIN me emrin e tij gjenerik Imatinib Mesylate 400mg.

Nga Vendimi nr.21/19 i datës 23.02.2019 i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, gjykata ka konstatuar se Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me datë 23.02.2019 me vendim nr. 21/19 ka mbyllur procedurën hetimore ndaj “Redoni H M” Sh.P.K, “Exclusive Corporation” dhe “Exclusive” Sh.P.K., të hapur me konkluzionin nr. 31/18 të datës 04.05.2018 me arsyetimin se nuk ka dëshmi se subjektet e cekura kanë bërë kurdisje të ofertave në tenderët e Ministrisë së Shëndetësisë për furnizim me barna nga lista esenciale për barin Imatinib Mesylate 400mg.

Për të vlerësuar dëmin e shkaktuar, përderisa sa çështja ka qenë në shqyrtim pranë Gjykatës Themelore në Prishtinës, sipas propozimit të përfaqësuesit të paditësit është caktuar ekspertizë financiare në këtë konflikt administrativ. Eksperti financiar R.B., në ekspertizën financiare të punuar me datë 15.09.2022 ka konstatuar se nuk ka mundur të bëjë vlerësimin e lartësisë së dëmit real të shkaktuar si shkak i mungesës së provave materiale të cilat nuk i ka bashkangjitur paditësi, ndërsa sa i përket vërtetimit të lartësisë së fitimit të pritur – humbur, nga të gjeturat në dokumentet që ka analizuar eksperti ka konstatuar se si rrjedhojë e vendimit të njoftimit për anulim të dhënies së kontratës, fitimi i humbur i paditësit ka vlerë prej 417,960.00€. Nga plotësimi i ekspertizës financiare e hartuar nga eksperti R.B. e datës 03.07.2023, eksperti ka konstatuar se pas analizimit të sasisë së ofertuar nga Ministria e Shëndetësisë, çmimit të barit “Imatinib Mesylate”, vlerës së kostos, vlerës së ofertuar nga Ministria e Shëndetësisë, eksperti konstaton se fitimi i humbur i paditësit pas tatimit është 392,445.00€.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri në procedurë administrative ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike për çfarë ka sjellë në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, përkatësisht nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik e cila ka rezultuar në nxjerrjen e vendimeve të kundërligjshme nga të paditurit.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur, gjykata iu referua nenit 62 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -068, i cili përcakton: “*I. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në*

*dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 1.1. një shkeljeje të ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit. 2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 2.1. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo 2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve”.*

Gjykata nga provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar, ka konstatuar se i padituri i dytë nuk ka pasur bazë ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizim me citostatik nga lista esenciale” me numër të brendshëm 206-17-3219-1-1-1 dhe nr. të prokurimit 206-17-030-111 Lot 17, pasi që nuk është plotësuar asnjëri nga kushtet e përcaktuara në nenin 62 të LPP-së i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -068 dhe pastaj i padituri i parë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale kur ka vërtetuar Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Gjykata nga provat e administruara në këtë çështje ka konstatuar se i padituri i dytë – Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues pas përfundimit të gjitha procedurave për vlerësimin e ofertave për këtë aktivitet të prokurimit, për Lot 17 ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik “Redoni H M” Sh.p.k. – këtu paditësin për çfarë me datë 03.10.2017 ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës për operatorin ekonomik “Redoni H M” Sh.P.K., me çmim 648,000.00€.

Gjykata po ashtu ka konstatuar se ndaj këtij njoftimi asnjë operator ekonomik nuk ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK, andaj ky njoftim për dhënie të kontratës është bërë i plotfuqishëm. Gjithashtu gjykata ka konstatuar se autoriteti kontraktues ka vazhduar procedurat për nënshkrimin e kontratës për çfarë përmes emailit të datës 16.10.2017 i kanë dërguar paditësit

drafin e kontratës për të verifikuar të dhënat dhe për të paraqitur vërejtjet eventuale në draftin e kontratës.

Vetëm pas përfundimit të gjitha procedurave të vlerësimit të ofertave (datë 02.10.2017), publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës (datë 03.10.2017) dhe fillimit të procedurave për nënshkrimin e kontratës (datë 16.10.2017), autoriteti kontraktues me datë 16.03.2018 publikon Njoftimin për Anulimin e Dhënies së Kontratës për aktivitetin e prokurimit numër të brendshëm 206-17-3219-1-1-1 dhe nr. të prokurimit 206-17-030-111 për Lot 17.

Gjykata vlerëson se Ligji për Prokurimin Publik lejon vetëm dy mundësi të anulimit të aktivitetit të prokurimit pas hapjes së ofertave të operatorëve ekonomik dhe një mundësi të anulimit të aktivitetit të prokurimit para hapjes së ofertave e që duhet të bëhet së paku tre ditë para hapjes së tenderëve. Gjithashtu gjykata vlerëson se neni 62 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -068 përdorë shprehjen “... *duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës ...*”, që gjykata vlerëson se përcakton mundësinë e anulimit të aktivitetit të prokurimit deri në publikimin e njoftimit për dhënien e kontratës ashtu që me publikimin e njoftimit për dhënien e kontratës aktiviteti i prokurimit nuk duhet të anulohet në asnjë rast. Ligji për Prokurimin Publik në dispozitat e saj bënë dallimin e qartë në mes të dhënies së kontratës (nenit 41 i LPP-së) dhe nënshkrimit të kontratës (neni 26 i LPP-së) andaj gjykata vlerëson se neni 62 i LPP-së i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -068 në mënyrë të qartë përcakton se Autoriteti Kontraktues duhet të përfundojë një aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës, ndërsa në rast se rezulton në dhënien e kontratës atëherë Autoriteti Kontraktues nuk mund të përfundojë një aktivitet të prokurimit pasi që i njëjti vetëm ka përfunduar me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës.

Gjithashtu, lidhur me gjendjen faktike të konstatuar si më lartë, gjykata vlerëson se nuk ka ndodhur ndonjë shkeljeje e ligjit aktual apo që do të ndodhte në procedurën e prokurimit, e cila shkelje nuk mund të rregullohej apo të parandalohej përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit përkatësisht asnjë dispozitë e LPP-së nuk ka kërkuar anulimin e aktivitetit të prokurimit si dhe nuk është plotësuar kushti tjetër për anulimin e aktivitetit të prokurimit se të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit, andaj gjykata ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka anuluar aktivitetin e prokurimit

në kundërshtim me neni 62 të LPP-së i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -068 pasi që aktiviteti i prokurimit veçse kishte përfunduar me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës si dhe nuk është plotësuar asnjëri nga kushtet e përcaktuara për të cilat mund të anulohet një aktivitet i prokurimit.

Lidhur me mundësinë e anulimit të një aktiviteti të prokurimi, gjykata ju referua edhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (versioni i datës 01.06.2017) i cili në nenin 44 par. 10 përcakton se: *“Në rast të anulimit bazuar në rrethana dhe arsye të deklaruar në këtë Nen, autoriteti kontraktues nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj tenderuesve, pjesëmarrësve ose kandidatëve për anulim të një procedure të prokurimit, subjekt i dispozitave të Nenit 105, paragrafi 2.9 të LPP në lidhje me kompensimin e ankuesit.”* dhe par. 11 që përcakton se: *“Pavarësisht nga ajo që është cekur më sipër, AK do të anulojë një Njoftimi për dhënie të kontratës, nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit “OSHP”, rekomandohet nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik “KRPP” apo në përputhje me paragrafin 10.2 të nenit 108/A të LPP-së. Në një rast të tillë AK do të përgatisë njoftimin e anulimit të Dhënies së Kontratës, të cilin e dërgon në KRPP për publikim dhe do t’u dërgojë njoftimin për anulim të gjithë OE që kanë treguar një interes në aktivitetin e prokurimit.”*

Lidhur me mundësinë e anulimit të Njoftimi për dhënie të kontratës nëse urdhërohet nga OSHP, gjykata vlerëson se me vetë faktin se operatori tjetër ekonomik nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në kuptim të nenit 108A të LPP-së, për të kontestuar procedurën e vlerësimit të aktivitetit të prokurimit, Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë i plotfuqishëm. Ndërsa lidhur me mundësinë e anulimit të aktivitetit të prokurimit për shkak të rekomandimit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), gjykata ju referuar emailit të datës 19.01.2018 si përgjigje në kërkesën e AK për interpretim ligjor. Nga vlerësimi i kësaj përgjigje të KRPP, gjykata nuk gjeti ndonjë rekomandim të prerë se si të veprojë AK, por në këtë interpretim ligjor, duke marrë për bazë fazën në të cilën gjendet procedura, KRPP paraqet mundësitë se çfarë mund të ndodhë në rast se AK vendosë të nënshkruaj kontratën dhe se çfarë mund të ndodhë në rast se vendos që të mos nënshkruaj kontratën dhe të anulojë aktivitetin e prokurimit duke theksuar *“Gjithsesi mbetet në përgjegjësinë e Autoriteti Kontraktues në këtë rast MSH-së në rast të konsekuencave që mund të rrjedhin nga vendimet për anulim apo vendimin për nënshkrim të kontratave dhe fillimin e zbatimit të tyre.”* Madje vetë KRPP e paralajmëron AK për pasojat ligjore

që mund të dalin në rast se anulohet aktiviteti i prokurimit duke theksuar se: “duke pas parasysh se faza në të cilën autoriteti kontraktues ndodhet (kur të gjitha afatet për kontestimin e kontratës kanë kaluar) dhe kushtet mbi të cilat një aktivitet i prokurimit mund të konsiderohet i përfunduar (nenit 62 i LPP-së dhe / ose neni 44 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik) autoriteti kontraktues duhet të ketë parasysh pasojat eventuale nga cili do vendim që merr.” Andaj, gjykata në këtë rast vlerëson se i padituri i dytë në kundërshtim me interpretimin e KRPP-së të dhënë përmes emailit të datës 19.01.2018, dhe duke qenë i paralajmëruar për pasojat, ka anuluar aktivitetin e prokurimit duke theksuar se “një rekomandim i lëshuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik kërkon anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës”

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe pretendimin tjetër në bazë të cilit është anuluar aktiviteti i prokurimit kontestues dhe atë se janë kërkuar informata shtesë mbi çmimet e tregut nga menaxhmenti i lartë i Ministrisë së Shëndetësisë dhe në bazë të dhënave të ofruara nga komisioni për verifikim të çmimeve si dhe kontrollimi i procedurës së prokurimit është konstatuar se ky aktivitet ka devijime nga LPP, përkatësisht se çmimi i ofruar nga paditësit është çmim më i lartë se çmimi i tregut. Gjykata lidhur me këtë, së pari ju referua Interpretimit Ligjor të KRPP-së të datës 19.01.2018 i cili lidhur me përcaktimit të çmimit të tregut, Autoritetin Kontraktues e ka udhëzuar që të çmimet ti marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës si autoriteti i vetëm përgjegjës për statistika në Kosovë. Përveç që AK nuk ka marrë statistikat e çmimit të barit “Imatinib Mesylate” nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Raporti në të cilin është bazuar, përkatësisht raporti me titull “raport rreth produktit Imanitib tlb 400mg”, gjykata konstatoi se nga hulumtimi që ka bërë Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale dhe Inspektoratit Farmaceutik i Kosovës në tregun e Kosovës ka hasur çmime në vlerë nga 4.83 euro deri në 32 euro për një tabletë, ndërsa në momentin e hulumtimi në treg ka qenë vetëm produkti i ofruar nga prodhuesi Remedica L.T.D me importues Exclusive Gjilan. Andaj gjykata vlerëson se lidhur me këtë, AK fillimisht këtë hulumtim është dashur ta bëjë para publikimit të njoftimit për kontratë ku ka caktuar vlerën e kontratës në shumë prej 1,196,266.00€; së dyti statistikat për çmimet në treg të produktit “Imatinib Mesylate” është dashur ti marrë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës sipas udhëzimit të KRPP dhe; së treti, hulumtimi që është bërë lidhur me çmimet në treg, përkundër që është konstatuar se të njëjtat nuk gjenden në treg, kanë konstatuar çmimin që janë shitur më parë nga operatorët tjerë, por që nuk plotësojnë kushtin e çmimit të produktit në treg pasi që nuk vazhdojnë të jenë prezent në treg.

Po ashtu gjykata vlerësoi se oferta e paditësit ka qenë për 270,000.00€ më e lirë se oferta e operatorit ekonomik “Exclusive Corporation” Sh.p.k., operator ekonomik i cili paraprkishte kishte furnizuar të paditurin e dytë me këtë produkt. Në raste të ngjashme vetë OSHP me Urdhëresën Psh.nr.273/17 të datës 23.02.2018 dhe Urdhëresën Psh.nr. 324/17 të datës 04.10.2017 kishte urdhëruar Autoritetin Kontraktues – Ministrinë e Shëndetësisë që të zbatojë njoftimin për dhënie të kontratës pasi që ka vlerësuar se pasi janë kaluar të gjitha fazat tjera procedurale në lidhje me aktivitetin e prokurimit dhe është bërë njoftimi për dhënie të kontratës atëherë konsiderohet se të gjitha procedurat kanë qenë në rregull.

Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se përderisa çmimi i ofruar nga operatori ekonomik është nën vlerën e parashikuar të kontratës, nuk ka bazë ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit për shkak të çmimit të ofertuar. Pra, paditësi në këtë aktivitet të prokurimit ka ofertuar me çmim prej 648,000.00€, ndërsa vlera e parashikuar e kontratës ka qenë 1,196.266.00€, andaj nuk gjeti bazë për anulimin e aktivitetit të prokurimit pasi që është publikuar njoftimi për dhënie të kontratës dhe i njëjti njoftim është bërë i plotfuqishëm.

Pretendimet e paditësit për dëmin material në formën e fitimit të humbur gjykata i vlerësoi në kuptim të nenit 137 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”* dhe në kuptim të nenit 173 i LMD-së përcakton se: *“1. I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur. 2. Lartësia e shpërblimit të dëmit caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse me ligj parashihet diçka tjetër. 3. Gjatë vlerësimit të lartësisë së fitimit të humbur merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas rrjedhjes së rregullt të gjërave ose sipas rrethanave të veçanta, e realizimi i të cilit është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmerret veprimin.”*

Po ashtu, gjykata ju referua nenit 119 të LPP-së i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-068 i cili përcakton se: *“1. Nëse parashtruesi i ankesës mendon se vendimi përfundimtar ose konstatimi i një paneli shqyrtues ose OSHP-ja është në kundërshtim me faktet ose me këtë ligj, parashtruesi i ankesës mund të kërkojë nga Gjykata Themelore shqyrtimin e vendimit. Kërkesa duhet të*

*dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e publikimit të vendimit të OSHP-së në përputhje me paragrafin 2 të nenit 117 të këtij ligji. 2. Nëse, pas shqyrtimit të cekur më lartë, gjykata konstaton se një pretendim i bërë nga parashtruesi i ankesës në ankesën e mëparshme që i është dorëzuar OSHP nuk ka qenë i pavlefshëm, gjykata do të lëshojë një urdhër duke kërkuar nga OSHP që të ia kthejë parashtruesit të ankesës dhe çfarëdo gjobe që i është vendosur atij sipas nenit 118 të këtij ligji. 3. Nëse pas shqyrtimit të cekur më lartë, gjykata konstaton se një pretendim i bërë nga parashtruesi i ankesës në ankesën e tij të mëparshme që i është dorëzuar OSHP-së është bërë në mënyrë të vlefshme, gjykata lëshon një urdhër (i) duke e shfuqizuar ose ndryshuar çfarëdo urdhri ose vendimi të marrë nga OSHP-ja, dhe/ose (ii) nëse parashtruesi i ankesës mund të demonstrojë se ai është dëmtuar nga veprimi ose mos-veprimi i autoritetit kontraktues, atëherë gjykata gjithashtu mund të kërkojë nga autoriteti kontraktues që t'ia paguajë parashtruesit të ankesës kompensimin për dëmin e shkaktuar.”*

Bazuar në par. 3 të nenit 119 të LPP-së, gjykata konstatoi se i padituri i dytë Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka legjitimitet real pasiv në këtë çështje pasi që kërkesa e paditësit për kompensim të dëmit është e drejtuar ndaj të paditurit të dytë, për çfarë, pretendimet e të paditurit të dytë për mungesë të legjitimitetit real pasiv gjykata i vlerësoi si të pabazuara.

Lidhur me pretendimet e paditësit për kompensimin e dëmit, gjykata vlerëson se për kompensimin e dëmit kërkohet të përmbushen dy elemente themelore: dëmi të ketë bazë ligjore dhe të ekzistojë lidhja kauzale ndërmjet veprimit dhe pasojës gjë që në këtë rast janë plotësuar pasi që ekziston baza ligjore për kompensimin e dëmit sipas LPP-së dhe LMD-së për shkak të pengimit të rritjes së saj (fitimit të humbur) dhe i padituri i dytë duke anuluar në mënyrë të kundërligjshme aktivitetin e prokurimit veprim ky i vërtetuar nga i padituri i parë, paditësit i ka pamundësuar rritjen e pasurisë.

Duke qenë se në këtë rast, Njoftimi për dhënie të kontratës i datës 03.10.2017 është bërë i plotfuqishëm, paditësi sipas rrjedhjes të rregullt të gjërave ka pasur pritje legjitime se do të nënshkruaj kontratën në përputhje me LPP-së dhe nga përmbushja e të njëjtës të realizoj fitim andaj gjykata vlerësoi se i njëjti duhet të kompensohet për shkak të fitimit të humbur. Një pritje e



tillë ka qenë e mbështetur edhe në vendimet paraprake të OSHP në rastet e ngjashme kur ka obliguar autoritetin kontraktues që të vazhdoj procedurat për nënshkrimin e kontratës.

Gjykata po ashtu vlerëson se ky rast dallon nga rastet kur aktiviteti i prokurimit anulohet para bërjes së plotfuqishëm të njoftimit për dhënie të kontratës për çfarë tek operatori ekonomik nuk krijon pritshmëri legjitime se do të nënshkruaj kontratën dhe do të realizoj fitim pasi që aktiviteti i prokurimit ende nuk ka përfunduar dhe në këto raste, kur gjykata konstaton shkelje të bëra nga autoriteti kontraktues apo OSHP, operatorit ekonomik i lind e drejta për kompensimin vetëm të shpenzimeve që i njëjti ka bërë gjatë aplikimit në aktivitet të prokurimit përkatësisht të dëmit material real, ndërsa duke qenë se në rastin konkret, siç është konstatuar më lartë, Njoftimi për dhënie të kontratës i datës 03.10.2017 është bërë i plotfuqishëm ashtu që aktiviteti i prokurimit ka përfunduar, gjykata vlerëson se paditësit duhet ti njihet e drejta për dëmshpërblim për shkak të humbjes së mundësisë së realizimit të fitimit. Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se trajtimi ndryshe i kësaj çështje do të humbte nevojën e shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve të OSHP dhe Autoriteteve Kontraktuese.

Lidhur me lartësinë e dëmit material, gjykata vendosi duke u bazuar në provën e nxjerrë me ekspertizë financiare me datë 15.09.2022 nga eksperti R.B. si dhe plotësimi i ekspertizës financiare i bërë me datë 03.07.2023 sipas vërejtjeve të dhëna nga gjykata. Duke qenë se me rastin e hartimi të ekspertizës së datës 15.09.2022 eksperti ka marrë për bazë çmimin e produktit “Imatinib Mesylate” bazuar në Dokumentin Unik Doganor R-533 të datës 15.01.2018 për importin e realizuar nga shoqëria tregtare “Liri Med” nga çfarë ka rezultuar fitimi i humbur në shumë prej 417.960.00€, gjykata në seancën e datës 05.06.2023 ka kthyer në plotësim ekspertizën financiare duke obliguar ekspertin që kalkulimin e fitimit të humbur ta bëjë duke marrë për bazë çmimin e koston së barit “Imatinib Mesylate” në rast të blerjes nga subjekti “Liri Med” duke i shtuar edhe shpenzimet operative, kjo duke qenë se të paditurit nuk kishin propozuar asnjë formë tjetër, përkatësisht provë në të cilën do të mund të bazohej llogaritja e çmimit të produktit “Imatinib Mesylate”. Nga plotësimi i ekspertizës financiare të datës 03.07.2023, eksperti financiar ka konstatuar se bazuar në faturën nr. 10005814 të datës 06.09.2018 çmimi për tabletë i barit “Imatinib Mesylate” ka qenë 5.67€ dhe kësaj shume i ka shtuar 38.3% marzhë të fitimit të cilin do ta kishte subjekti furnizues i paditësit nga çfarë ka rezultuar në çmimin total prej 7.85€ për tabletë të barit “Imatinib Mesylate” apo kostoja totale për sasinë e këtij aktiviteti të prokurimit në shumë prej

211,950.00€ dhe vlera prej 43,605.00€ në emër të tatimit në fitimit, nga çka për paditësin do të mbetëj fitimi në vlerë prej 392.445.00€.

Gjykata bazuar në nenin 56.10 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (versioni i datës 01.06.2017) i cili përcakton se: *“56.10 Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht”*, konstatoi se në të gjitha rastet kur autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, lejohet mospërputhja e porosive me sasinë indikative deri në plus/minus 30%, pra autoriteti kontraktues mund të bëjë blerje të sasisë indikative deri në 70% të totalit saj apo deri në 130% të sasisë indikative, andaj gjykata në këtë rast, vlerën totale të dëmi material (fitimit të humbur) të konstatuar nga eksperti financiar në plotësimin e ekspertizës e shumëzoi me 70% nga çfarë rezulton shuma prej 274,711.50€ (dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë euro e pesëdhjetë cent) si shumë që paditësit duhet ti shpërblehet në këtë rast.

Gjykata refuzoi pjesën tjetër të kërkesëpadisë në shumë prej 117,733.50€ (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre euro e pesëdhjetë cent) pasi që vlerësoi se në kuptim të nenit 56.10 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (versioni i datës 01.06.2017), porositë për vlerën përtej 70% të sasive indikative janë në diskrecion të autoritetit kontraktues dhe nuk paraqesin obligim për autoritetin kontraktues andaj në këtë rast gjykata vlerësoi se për këtë sasi nuk mund të caktohet kompensimi i dëmit për paditësin.

Në fund, gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurit të parë se e OSHP ka kompetenca ta shfuqizojë plotësisht apo pjesërisht kontratat publike në rastet e caktuara kur nënshkrimet e këtyre kontratave apo zbatimet e tyre janë të dëmshme dhe me pasoja për interesin publik, por gjykata këto pretendime i gjeti të pabazuar në rastin konkret, pasi që neni 105 par.2, nën-par. 2.6 i LPP-së përcakton se: *“2. OSHP ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi, në kuadër të kushteve*

*të saktësuara në këtë Pjesë IX që: ... 2.6. nëse kontrata përkatëse nuk është nënshkruar ende ligjërisht nga të dy palët, dhe deri më tani të lejuar nga ky ligj, të japin urdhër me të cilën mënjanohet ose pezullohet dhënia e kontratës publike ose rezultati i një konkursi të projektimit;”* ashtu që kompetenca e OSHP për të urdhëruar mënjanimin ose pezullimin e dhënies së kontratës publike duhet të jetë e lejuar me Ligjin i Prokurimit Publik e që nga arsyetimi i paraqitur më lartë ka rezultuar se nuk ka ekzistuar baza ligjore që një veprim i tillë të ndodhë. Pra OSHP nuk ka kompetencë të pakufizuar në të drejtën për të urdhëruar mënjanimin ose pezullimin e dhënies së kontratës publike, por kjo kompetencë duhet të autorizohet nga një dispozitë e LPP e që në rastin konkretë dispozitat e LPP-së nuk lejojnë anulimin e aktivitetit të prokurimit i cili ka përfunduar me publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës dhe mos kontestimit të njëjtit nga operatorët tjerë ekonomik pjesëmarrës.

Gjykata vendosi si në pikën I dhe IV të dispozitivit të këtij Aktgjykimi mbështetur në nenin 46 par. 4 të LKA-së që përcakton se: *“4. Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”*, ashtu që duke qenë se në rastin konkret nuk ka pasur bazë ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull “Furnizim me citostatik nga lista esenciale” me nr. të prokurimit 206-17-030-111, Lot 17, pasi që nuk është plotësuar asnjëri nga kushtet e përcaktuara në nenin 62 të LPP-së i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -068, gjykata vendosi që të anulojë Vendimi Psh.nr. 126/18 i datës 11.05.2018 i nxjerrë nga i padituri i parë Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe Njoftimi për Anulimin e Dhënies së Kontratës i datës 16.03.2018 për aktivitetin e prokurimit numër 206-17-3219-1-1-1, i nxjerrë nga i padituri i dytë Ministria e Shëndetësisë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktgjykimi mbështetur në nenin 46 par. 5 të LKA-së që përcakton se: *“5. Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestimore”*, ashtu që gjykata në kuptim të nenit 119 par.3 të LPP-së i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-068 vendosi të obligoj të paditurin Ministria e Shëndetësisë, që paditësit në emër të kompensimit

të dëmit për shkak të fitimit të humbur, ti paguaj dëmin në vlerë prej 274,711.50€ (dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë euro e pesëdhjetë cent) të cilat paditësi është obliguar ti paguaj me kamatë vjetore prej 8% duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në përmbushjen përfundimtare, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën ligjore gjykata vendosi në bazë të nenit 378 dhe 382 par. 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ashtu që duke qenë se e drejta e kompensimit të dëmit material në formën e fitimit të humbur është përcaktuar së bashku me shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve kontestuese, gjykata vendosi që kamatëvonesa të paguhet nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi në përputhje me nenin 64 të LKA-së.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,**

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.1428/22, datë 13.09.2023.

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimin të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.